



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 2323/Prot.
4

Tiranë, më 18.03.2020

Lënda: Sqaruese mbi Udhëzimin Nr. 05 datë 19.03.2020 “Mbi lehtësimin e procedurave të përfimit të barnave me rimbursim pranë banesës për pacientët e grupmohës mbi 65 vjeç.”

Në zbatim të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Urdhrit të Kryeministrit “Për ndalimin e lëvizjes së pensionistëve”; Kontratës me dhënësit e shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor për Vitin 2020; Kontratës me subjektet farmaceutike për vitin 2019 dhe me qëllim mbrojtjen e shëndetit të të moshuarve nga infeksioni i shkaktuar nga Virusi COVID-19, sqarojmë si më poshtë vijon:

1. Farmacitë / Agjencitë Farmaceutike të rrjetit të hapur, të cilat kanë kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në bashkëpunim me dhënësit e shërbimit shëndetësor publik parësor të mundësojnë dërgimin e barnave pranë banesave për pacientët kronikë të cilët janë të moshës 65 vjeç e lart, të cilët jetojnë vetëm dhe nuk kanë familjarë / të afërm që kujdesen për ta, përgjatë periudhës së rrezikut nga pandemia e shkaktuar nga Virusi COVID-19.
2. Në vijim të procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Fondit me Nr. 4, datë 12.03.2020 “Mbi kufizimin e lëvizjes së pacientëve në sistemin shëndetësor publik parësor” mjeku i përgjithshëm / mjeku i familjes i komunikon (me telefon, sms apo mënyra të tjera elektronike, si p.sh: skype, whatsapp, etj.) kodin / kodet e recetave pacientit.
3. Mjeku i përgjithshëm / mjeku i familjes merr kontakt me telefon me pacientin, e informon mbi kodin / kodet e recetave, e pyet nëse ka familjarë ose të afërm që mund të paraqiten në farmaci / agjenci farmaceutike për të tërhequr barin / barnat me rimbursim dhe nëse ka një farmaci / agjenci farmaceutike ku dëshiron të marrë barin / barnat me rimbursim.
4. Në rastet kur pacienti informon mjekun e përgjithshëm / mjekun e familjes se nuk ka familjarë ose të afërm që mund të paraqiten në farmaci / agjenci farmaceutike për të tërhequr barin / barnat me rimbursim dhe nuk ka një farmaci / agjenci farmaceutike ku

- dëshiron të marrë barin / barnat me rimbursim, mjeku i përgjithshëm / mjeku i familjes informon pacientin mbi farmacinë / agjencinë farmaceutike ku pacienti ka ekzekutuar recetat e fundit me rimbursim, sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi e-RX, e informon mbi barin / barnat me rimbursim dhe mbi alternativat tregtare dhe i shpjegon mundësinë e dërgimit të barnave pranë banesës.
5. Pas daktortësisë së pacientit lidhur me farmacinë / agjencinë farmaceutike ku do të ekzekutohet receta / recetat me rimbursim dhe alternativat tregtare të barnave me rimbursim, mjeku i përgjithshëm / mjeku i familjes i dërgon farmacisë / agjencisë farmaceutike, kodin / kodet e recetave, NID-in e pacientit dhe numrin e kontaktit të tij apo të familjarit të tij.
 6. Lista emërore e pacientëve mbi 65 vjec, e cila do të ketë informacion mbi farmacinë/ agjencinë farmaceutike e rrjetit të hapur ku pacienti ka ekzekutuar recetat e fundit me rimbursim si edhe numri i kontaktit për farmacinë / agjencinë farmaceutike përkatëse do të sigurohen (në rrugë elektronike) nga Drejtoritë Rajonale / Degët e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për çdo Qendër Shëndetësore / Mjek Familje të kontraktuar nga ana e tyre.
 7. Farmacisti / ndihmës farmacisti merr kontakt me telefon me pacientin (ose me familjarin e tij) dhe e sqaron pacientin / familjarin e tij në lidhje me barnat që ka përshkruar mjeku në recetën / recetat me rimbursim; mënyrën e përdorimit të tyre; alternativat tregtare të mundshme për tu zgjedhur si dhe çdo aspekt tjetër që ai e gjykon profesionalisht të nevojshëm.
 8. Në të gjitha këto raste farmacisti / ndihmës farmacisti i shpjegon pacientit / familjarit në mënyrë të hollësishme për nevojën për bashkëpagesë (nëse do të ketë të tillë) që mund të lindë nga zgjedhjet e bëra prej tij.
 9. Në rastet kur pacienti / familjari dhe farmacisti/ ndihmës farmacisti dakortësohen përse më sipër, nga ana e farmacisë / agjencisë farmaceutike kryhet ekzekutimi i recetës/recetave me rimbursim duke zbatuar të njëjtat procedura (dhe plotësuar dokumentacionin përkatës) si në rastet kur pacienti paraqitet në farmaci/agjenci farmaceutike.
 10. Farmacisti / ndihmës farmacisti pregatit barin/barnat për pacientin sipas recetës / recetave të ekzekutuara dhe të printuara nga sistemi e-RX dhe realizon dërgimin e tyre pranë vendbanimit të pacientit.
 11. Në momentin e dorëzimit të barnave pacientit do të kryhet bashkëpagesa (nëse do të ketë të tillë), kundrejt zbatimit të të gjitha procedurave financiare apo tatimore në fuqi dhe do të nënshkruhet në pjesën e pasme të recetës / recetave nga pacienti marrja në dorëzim e barit / barnave për të siguruar gjurmueshmërinë e tyre.

12. Gjithashtu gjatë procesit të dorëzimit të barit / barnave duhet të respektohet në mënyrë rigoroze perimetri i sigurisë dhe distanca midis pacientëve dhe ofruesve të këtij shërbimi të jetë me masa mbrojtëse dhe jo më pak se 1.5 metër nga njëri-tjetri.
13. Ngarkohen Drejtoritë Rajonale / Degët e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të cilët në koordinim me Drejtoritë Rajonale / Njësitë Vendore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të marrin masat për zbatimin e këtij Udhëzimi dhe njoftimin e të gjithë dhënësve të shërbimit shëndetësor publik parësor dhe farmacive / agjencive farmaceutike të rrjetit të hapur të kontraktuar nga ana e tyre.
14. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet përgjatë gjithë kohës së rrezikut nga pandemia e shkaktuar nga Virusi COVID-19.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rudina Degjoni

